



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA VUSHTRRI

DREJTORIA PËR EKONOMI, BUJQËSI DHE ZHVILLIM

PLANI I PUNËS 2012

Vushtrri, 2011

DREJTORIA PËR EKONOMI, BUJQËSI DHE ZHVILLIM
PLANIFIKIMI I ANGAZHIMEVE 2012

Participojnë							
Nr.	Emri i projektit	Shuma-€	Komuna	Donatorët	Përfituesi	Koha e realizimit	Detaje
1	Zhvillimi i aktiviteteve dhe përpjekjet për kushte më të mira në QKB					Gjithë vitin	Qendra Komunale e Biznesit tani afro një vit është në funksionim të mbarë dhe si e tillë është në kursim të mjeteve financiare dhe të kohës për të gjithë të interesuarit për të zhvilluar biznes: Përpjekjet tona do të jenë për eliminimin e të gjitha barrierave për të bërë biznes, në shkurtrim të kohës për regjistrim të biznesit, dhe në përpjekje me rekomandime profesionale në përmirësim të ngarkesave komunale në raport me bizneset. Planifikohet që në QKB nga viti 2012 të bëhet edhe pajisja me : -certifikatën e biznesit ; -certifikatën e nr.fiskal ; -certifikatën e nr.TVSH ; -certifikatën e doganës ; -Bartës së aktiviteteve janë : -z.Shaip Neziri, -znj.Ragbete Melenica, -z.Selim Pllana
2	Bashkëpunimi me ARBK-ën dhe MTI					Gjithë vitin	QKB do të jetë në vazhdimësi në bashkëpunim me ARBK-ën, MTI dhe ATK-ën, kryesisht në këto punë: -raportimin javor në ARBK ; -barazimin financiar mujor me ARBK-n; -ngarkimin mujor me material zyrtar për funksionim normal të QKB(certifikata, aplikacione, blloka të pagesave, etj); -skenim të aplikacioneve dhe dokumentacionit përcjellës;

							-Bartës së aktivitetit: -z.Shaip Neziri,menaxher në zyrë.
3	Rregullimi i lumenjve dhe bademeve	18.000	18.000			Qershor-Gusht	Me këtë projekt synohet që të ndikohet në ruajtjen e tokave bujqësore,duke parandaluar dëmet nga vërshimet. -Bartës i projektit: -Drejtori për EBZH; -Menaxheri i zyrës për bujqësi z. T.Maloku
4	Blegtori	60.000	25.000	35.000		Mars-Qershor	Në këtë kategori planifikojmë që t'i kryejmë obligimet ndaj "Hejfer Kosova" nga viti 2011 në shumë prej 7.000 € dhe me po të njëjtin donator planifikojmë të realizojmë edhe një projekt tjetër gjatë vitit 2012 në blegtori. Nga 25000 € buxhet komunal të këtij projekti, 7.000 € paguhen obligime nga projekti i njëjtë 2011. -Bartës dhe menaxher në projekt: -Drejtori për EBZH N.Aliu; -Organizata implementuese OJQ "GLV"; -Mbikëqyrja nga "HPI Kosova".
5	Perimekulturë	35.000	35.000	B.Financim	B.Financim	Mars-Prill	Me këtë projekt synojmë që të zhvillojmë investime në lëmin e ndërtimit të serrave.Jemi në përpjekje që këtë projekt ta realizojmë në bashkëpunim me ndonjë donator. Jemi në zhvillim e sipër të disa

							takimeve me USAID-in dhe CDF për ta bashkëfinancuar një projekt të madh të 20 serrave izraelite me hapësirë 2 ha,në të cilin planifikohet të bashkëfinancohet komunë-përfitues dhe CDF . -Bartës të projektit : -Drejtori për EBZH N.Aliu -Menaxheri i zyrës për bujqësi z.Tefik Maloku
6	Blerje e një automjeti për pylltari	7.000	7.000			Shkurt-Mars	Sektori i pylltarisë është në funksion me një automjet në gjendje jo të mirë teknike dhe shpeshherë jofunksional.Me këtë synohet sado pak të përmirësohen kushtet e pylltarëve në mbrojtje të pyjeve. -Bartës në mbrojtje të pyjeve: -Menaxheri i zyrës për pylltari.
7	Dita e patates		5.000	MBPZHR		1-10/Tetor	Organizimi “Dita e patates”që nga viti 2012 do të jetë në organizim të organeve komunale dhe ka karakter të promovimit të kësaj kulture nga komuna jonë, fermerëve të vyeshëm,sukseseve të kompanisë”Pestova”, investimeve nga fermerët dhe kompania si dhe paraqitjen e inovacioneve teknologjike për çdo vit. -Bartës të këtij aktiviteti festiv: -Organizator DEBZH,N.Aliu,dhe menaxheri i zyrës për bujqësi z.T.Maloku,

							-Drejtoria për KRS, -Drejtoria për Inspektion, -MBPZHR, -Kompania "Pestova",
8	Dita e mjalitit		200		-Bletarët, -Shoqata "EMA", -Bizneset		Bletarët e komunës sonë në çdo vit organizojnë në mënyrë shumë shembullore ditën e promovimit të mjalitit "Dita e mjalitit". Shoqata "EMA" është një nga shoqatat më të suksesshme në nivel të shtetit. Kjo veprimtari bujqësore në bazë të të dhënave që kemi në vazhdimësi është në rritje e sipër, andaj do të ketë edhe vëmendjen dhe përkushtimin tonë si institucion. -Bartës të aktivitetit dhe në mbështetje (vizitë) do të jenë: -Kryetari i komunës z. Mulaku; -Nënkryetari i komunës z. Përçuku; -Drejtori EBZH N. Aliu;
9	Panairi Regjional i Prodhimeve Vendore		500	IADK, Bankat, Bizneset, Komunitat e regjionit, AZHR-Veri		Shtator	Ne drejtorët për EBZH nga komunitat regjionale në bashkëpunim me OJQ "IADK", jemi dakorduar që të organizojmë në çdo vit Panairin Regjional të Prodhimeve Vendore. Panairi do të lëvizë me rotacion në çdo komunë dhe do të ketë karakter të promovimit të resurseve dhe të të gjitha prodhimeve që fermerët ose kultivuesit t'i prezantojnë. -Bartës të këtij aktiviteti: -IADK; -Komunitat e regjionit;
10	Eliminimi i qenve endacak		8000			Shkurt/Prill Nëntor/Dhjetor	-Ky aksion është i bazuar në çdo plan vjetor të aktiviteteve nëpër drejtoritë komunale. Aksioni realizohet në dy pjesë gjatë vitit dhe bëhet me qëllim të sigurisë për fëmijët dhe qytetarët në përgjithësi. -Bartës i aktivitetit: -z. Avdyl Feka;

							-Shoqata e gjuetarëve"Qyqavica"
11	Vaksinimi i qenve shtëpiak		3.500			Qershor/Shtator	Vaksinimi bëhet në kuadër të përgjegjësiive ligjore dhe me qëllim mbrojtjeje nga sëmundjet e ndryshme. -Bartës i aktivitetit : -z.Tefik Maloku, menaxher i zyrës për bujqësi
12	Mbjelljet pranverore/vjeshtore					-Shkurt/Prill -Shtator/Nëntor	Bazuar në aktivitetet e fermerëve vushttrrias dhe resurseve bujqësore që ka komuna jonë,Drejtoria për EBZH ka për obligim që të përcjellë të gjitha mbjelljet,të mbajë statistika të këtij lloji dhe të ketë gjithmonë njohuri për orientimin dhe zhvillimin e vendit tonë në kulturat bujqësore. -Bartës në këtë aktivitet: -z.Tefik Maloku-menaxher zyreje, -z.Avdyl Feka-agronom, -znj.Rabije Zahiti-zyrtare,
13	Korrje-shirjet					Korrik/Gusht	Në këtë aktivitet organet komunale janë obligative që të përcjellin procesin,të ndajnë territorin e autokombajnave,të caktojnë komisionin për mbikëqyrje,të mbledhin statistika,ndërsa listën e autokombanjerëve dhe të rendimentit duhet ta dërgojnë në MBPZHR. -Bartës të aktivitetit : -Drejtori i EBZH ; -Zyra për bujqësi, -Komisioni komunal.
14	Publikimi i fletushkës së drejtorisë për qytetarë			AZHR-Veri USAID Bizneset Komuna		Nëntor/Dhjetor	Publikimi i fletushkës do të jetë pjesë e rëndësishme e planifikimit të Drejtorisë për EBZH,duke e bartë si qëllim informimin e të gjithë qytetarëve për të gjitha aktivitetet e DEBZH,e gjithë qeverisë komunale si dhe të donatorëve mbështetës në zhvillimin ekonomik lokal.

							-Bartës i këtij aktiviteti: -Drejtori i drejtorisë, -Menaxherët e zyrave.
15	Subvencionimi i grurit			MBPZHR		Pranverë/ Vjeshtë	Subvencionimi i grurit bëhet në çdo vit dhe në bazë të praktikës së deritanishme, ka filluar kryesisht në stinën pranverë ose vjeshtë. -Bartës të aktivitetit: -z.Avdyl Feka, -znj.Rabije Zahiti.
16	Pyllëzim					Pranverë/ Vjeshtë	Planifikohet që në vitin 2012 të bëhet pyllëzimi me afro 50.000 fidane. -Bartës dhe monitorues të këtij aktiviteti: -Menaxheri i sektorit të pylltarisë.
	GJITHSEJ :	137.200~150.000 €	102.200€	35.000 €			

Analizë:

-1-Realizimi i projektit për rregullim të bademeve(bankinës)është projekt shumë kapital dhe afatgjatë. Rëndësia e këtij projekti qëndron në faktin që komuna në vitin 2011 ka filluar me projektin e parë në këtë drejtim dhe për synim kemi parandalimin e vërshimeve nga reshjet në tokat bujqësore. Gjatë viteve lumi “Silnica” si rezultat i reshjeve të mëdha në disa vende ka devijuar rrjedhën dhe në shumë raste është afër shpërthimit në toka me mbjellje të kulturave të ndryshme, veçmas patates. nvestimet në këtë projekt kursejnë qindra-mijëra euro nga xhepat e fermerëve.Është projekt me kosto të lartë financiare por mendohet që gradualisht në çdo vit të kemi mjete buxhetore të planifikuara për këtë projekt dhe të rregullohen të gjithë bedenat,me prioritet pikat më emergjente.

-2-Në vitin 2010 është arritur një marrëveshje bashkëpunimi ”Komunë e Vushtrrisë-Hejfer Kosova”(OJQ e mbështetur nga donatorë kanadez me seli në Prishtinë)me të cilën nënkuptohet financimi i përbashkët i projekteve në blegtori, konkretisht në pajisjen e familjeve të caktuara në gjendje të rëndë me nga një lopë qumështore, për ato familje që kanë kushte ideale për kujdesje. Kjo marrëveshje për herë të parë këtë vit 50 % u realizua me 10 kafshë(+ 10 të tjera në pranverë 2012) në tri fshatrat Sumë-Tërllobuq-Korçë, gjithmonë konform rregullave të donatorit. Në këtë projekt komuna financon 35 % të vlerës të përgjithshme të projektit. Të njëjtin projekt planifikojmë ta realizojmë edhe gjatë vitit 2012 në tri fshatra tjera të afërta me njëra-tjetrën. Përfituesit e këtyre kafshëve paraprakisht nënshkruajnë marrëveshjen për pasim të viçit të parë femër pasi t'i ketë mbushur një vit kafsha(në peshë 350 kg) dhe në këtë mënyrë planifikohet që nga 20 të përfitojnë 40 familje. Kjo marrëveshje synojmë të jetë e vazhdueshme në vite.

Qëllimi final i këtij projekti është përmirësimi i racës së gjedheve me llojin evropian simental dhe ndihmesa e ekonomive të rënda familjare si dhe përkrahje direkte e sektorit të blegtorisë.

-3-Në komunën e Vushtrrisë në vitet e fundit vërehet dukshëm një orientim i madh i fermerëve në ndërtim të serrave me qëllim të kultivimit të perim-kulturave.Veçmas dallohet kultivimi i specave, domates dhe kornishonit(trangujve të vegjël).Ky investim në serra për fermerët tonë është një burim i mirë për një mirëqenie më të mirë familjare duke gjeneruar të hyra. Investimet në këso projekte zbusin papunësinë, krijojnë të hyra për fermerët tonë dhe të gjithë qytetarët kanë mundësi të shërbehen me produkte kualitative, më të freskëta por edhe me çmime më të lira për faktin se nuk i nënshtrohen importit. Nga këto aktivitete bujqësore në vazhdimësi janë në rritje ekonomitë familjare.

-4-Pyjet në komunën tonë, ashtu si në gjithë territorin e Kosovës nuk janë në gjendje të mirë. Si rezultat i pranimi të kompetencave nga MBPZHR dhe me qëllim mbrojtjen dhe kujdesin ndaj pyjeve, llogarisim se na duhet të ndërmarrim hapa konkret në këtë drejtim. Andaj, blerja e një automjeti për këtë sektor do të ishte një nga elementet që do të na mundësonte një ruajtje dhe një funksionim më të mirë të përgjegjësve pyjor.

-5-Planifikohet që me kërkesën tonë të gjejmë mbështetje nga MBPZHR që të mbjellim sipërfaqe të reja me fidane që do të pyllëzonim kryesisht këto vende: 1/Qukë e Skoçnës, 10 ha me pishë të bardhë 12.500 fidane,me fidane të zezë 12.500 copë; 2/Qyqavicë(te antena) 10 ha,pishë hormoq 25.000 fidane dhe 3/ Vendin e quajtur Bukogllavë(Vesekoc) 10 ha ,pishë hormoq me 25.000 fidane.

Objektivat :

- 1/ Stimulimi i zhvillimit të bujqësisë;
- 2/ Ruajtja dhe punimi i tokës bujqësore;
- 3/ Përmirësimi i klimës për të bërit biznes;
- 4/ Përmirësimi i klimës për tërheqjen e investimeve;
- 5/ Ruajtja e pyjeve;

Rekomandimet :

Analizuar gjendjen në të cilën gjendet vendi, njëkohësisht edhe shumë faktorëve të tjerë që mundësitë mund të shndërrohen në një realitet shumë domethënës në përmirësim të cilësisë së jetës së qytetarëve tonë, siç janë:

- përkrahja e donatorëve aktual dhe të tjerëve të mundshëm si: USAID,CDF,KE,IADK,HPI(Hejfer Kosova),etj ;
- fondet(grandi dhe subvencionet)që ndanë MBPZHR-ja;
- mundësitë(potencialit)që ka komuna e Vushtrrisë;
- vullneti i madh i fermerëve tonë;

Drejtoria për Ekonomi,Bujqësi dhe Zhvillim, me qëllim të përmbushjes së objektivave të saj rekomandon që buxheti komunal i kësaj drejtorie që nga viti 2013 të jetë me pragu minimal 400.000 euro.

Arsyetim:

DEBZH planifikon shpenzimin e këtyre mjeteve në mënyrë shumë racionale me synim për të gjeneruar efekte të rëndësishme në ekonomitë familjare të vendit.

-Shpenzimi i tyre do të bëhej kryesisht në kultivimin e kulturave të ndryshme bujqësore, me të cilat për synim do të kishim zëvendësimin e prodhimeve të importuara. Nga kjo mbështetje të gjithë qytetarët do të ishin përfitues për faktin që kostoja e blerjes do të ishte më e nivelizuar me standardin e jetës në Kosovë. Nga këto mbështetje drejtpërsëdrejti do të përfitonin familje të shumta gjithmonë duke ju nënshtruar procedurave të prokurimit siç parashohin ligjet në fuqi, ndërsa në mënyrë indirekte do të ndikoheshin pozitivisht të gjithë qytetarët e vendit.

-Me mbështetjen institucionale ndaj qytetarëve tonë, konsideroj që do të krijonim shumë elemente nxitëse për të zhvilluar ekonomitë familjare, sepse një buxhet i tillë i propozuar do të mund të rritej në vlerë nga bashkëfinancimi me donatorë dhe nga vetë përfituesit.

Efektet e drejtpërdrejta do të ishin:

- nxitja e fermerëve me kujdes nga organet komunale dhe institucionet;
- nxitja e më shumë qytetarëve në punim të tokës;
- nxitja e të rinjve për të zhvilluar ide të reja dhe kreative, për të zhvilluar biznese të qëndrueshme familjare;
- mënyra më e mirë e mbrojtjes së tokës kualitative;
- zbutja e papunësisë;
- mbushja e tregut me produkte të vendit;
- çmime më të lira;

Drejtori:
Nasuf Aliu